



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të grupit të operatorëve ekonomik "Triangle Sh.P.K. & Çeta - General Invest Group & AAB Construction Sh.P.K" të datës 06.04.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 03.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i aneksit të shkollës Pavarësia" me nr. të prokurimit 616-22-8923-5-1-2 dhe nr. të brendshëm 616 22 128 511, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** kërkesa për rishqyrtim e grupit të operatorëve ekonomik "Triangle Sh.P.K. & Çeta - General Invest Group & AAB Construction Sh.P.K" të datës 06.04.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 03.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i aneksit të shkollës Pavarësia" me nr. të prokurimit 616-22-8923-5-1-2 dhe nr. të brendshëm 616 22 128 511 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 03.04.2023 i autoritetit kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në rivlerësim aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik "Triangle Sh.P.K. & Çeta - General Invest Group & AAB Construction Sh.P.K" si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Grupi i operatorëve ekonomik Triangle Sh.P.K. & Çeta - General Invest Group & AAB Construction Sh.P.K" (tutje "parashtruesi") me datë 06.04.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues - Komuna e Prishtinës të datës 03.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i aneksit të shkollës Pavarësia" me nr. të prokurimit 616-22-8923-5-1-2 dhe nr. të brendshëm 616 22 128 511.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim.

- 1. Pretendimi i parë:** *“Këto noterizime nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit sepse nuk janë më të vjetra se gjashtë muaj. Pikërisht për këta inxhinier janë ofruar edhe noterizime tjera që janë bërë në gjashtë muajt e fundit por që janë bërë edhe noterizime nga kopja, e jo nga origjinali. Këto dëshmi ngritin dyshime edhe dilema për mundësinë e përdorimit të dokumentacionit të inxhinierëve pa lejen e tyre... tek fajlli diploma të noterizuara, ku të gjitha janë të bëra me dt. 23.12.2022 dhe të njëjtat nuk janë të noterizuara në prani të vet inxhinierëve mirëpo janë të bëra nga znj. Meliza Ademaj....”.*
- 2. Pretendimi i dytë:** *“OE i rekomanduar për kontratë në ofertë ka prezantuar si inxhinier të hidros z. Astrit Salihu të cilit kur i analizohet CV-ja shihet qartë se nuk e posedon përvojën e punë në vitet e kërkuara. Gjithashtu për të njëjtin është prezantuar edhe një referencë e cila është e lëshuar nga OE i rekomanduar për kontratë mirëpo e njëjta referencë nuk mund dhe nuk duhet ti merret parasysh për faktin se në CV askund nuk figuron që ky inxhinier ka qenë i angazhuar tek OE i rekomanduar për kontratë”.*
- 3. Pretendimi i tretë:** *“Kur analizohet CV-ja e të njëjtit figuron se Arban Grajqevci ka përfunduar studimet bachelor me dt. 15.12.2025 ndërsa tek përvoja e punës në CV figuron se i njëjti ka punuar te kompania Consult Engineering SHPK me dt. 02.09.2015. Kur analizohet data e diplomimit bachelor dhe data që i njëjti ka pretenduar se ka punuar në kompaninë e lartëcekur, kuptohet qartë se të njëjtit nuk mund ti merret parasysh fare puna në kompaninë e lartëcekur pasi që i njëjti në atë kohë nuk ka qenë i diplomuar... OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar dy referenca ku njëra nga to është e lëshuar nga kompania Consult Engineering SHPK për të cilën siç edhe e cekëm nuk mund dhe nuk duhet ti merret parasysh për faktin se në momentin e fillimit të punës i njëjti nuk ka qenë i diplomuar. Gjithashtu edhe referenca e lëshuar nga Rexha SH.P.K. – OE i rekomanduar për kontratë nuk mund dhe nuk duhet ti merret parasysh për faktin se në CV e të lartëcekurit askund nuk figuron që i njëjti ka punuar tek OE i rekomanduar për kontratë...”.*

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 60, 64 dhe 69 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”) si dhe neni 10 i Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurim Publik.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit, janë administruar këto prova materiale si në vijim:

- Dosja e tenderit e datës 22.12.2022;
- Oferta e GOE “Rexha & Termomontimi”;
- Raporti i komisionit për vlerësim i datës 03.04.2023;
- Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontratës i datës 03.04.2023.

Parashtruesi nuk i ka bashkangjitur kërkesës për rishqyrtim asnjë provë materiale për të dëshmuar pretendimet e tij.

Pas njoftimit të datës 27.03.2023 për zgjatje të afatit për shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim në përputhje me nenin 61 paragrafin 61.3. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP"), autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 13.04.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim. Pas analizimit të pretendimeve të parashtruesit është gjetur se pretendimi i parë është **tërësisht i pabazuar** në kuptim të nenit 62 paragrafit 62.1. nën paragrafi d) të RRPP. Njëkohësisht është gjetur se pretendimi i dytë dhe i tretë janë pretendime **vetëm pjesërisht të bazuara** në kuptim të nenit 63 paragrafit 63.1. nën paragrafi 63.1.2. të RRPP.

Pretendimi i pabazuar

Lidhur me pretendimin e parë: fillimisht duhet cekur se të gjitha pretendimet (jo vetëm pretendimi i parë) ka të bëjë me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale në Dosjen e Tenderit (tutje "DT") rubrika 9.1 & 9.2 ku përcaktohet se "*OE duhet të ofroj dëshmi për stafin profesional...*" ashtu që duhet të dorëzoj "*CV, Diploma e noterizuar (jo më të vjetër se 6 muaj 2022), Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt, Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar...*" etj.

Në pretendimin e parë parashtruesi në fillim pretendon se diplomat e dorëzuara nga tenderuesi i rekomanduar nuk janë noterizuar në gjashtë muajt e fundit. Më tutje konstaton se tenderuesi i rekomanduar i dorëzuar këto dokumente të noterizuara brenda gjashtë muajve të fundit sipas DT. Në këtë mënyrë parashtruesi brenda të njëjtit pretendim të tij në mënyrë kontraverze nxjerr dy konstatime kundërtëdhënëse dhe në kundërshtim me njëra tjetrën. Nga analizimi i ofertës së tenderuesit të rekomanduar si provë materiale në këtë rast është gjetur se diplomat përkatëse janë dorëzuar si të noterizuara brenda gjashtë muajve të fundit sipas DT. Kjo është konfirmuar edhe nga raporti i komisionit vlerësues.

Në pjesën tjetër të pretendimit të parë thuhet se parashtruesi ka dyshime se diplomat e stafit profesional janë noterizuar pa dijeninë e stafit profesional pasi që të gjitha ato brenda ditës së njëjtë (23.12.2022), pastaj noterizimi është bërë nga kopja dhe jo nga origjinali si dhe noterizimi është në prezencën e një personi i tretë. Sa i përket kësaj pjese të pretendimit, duhet cekur se vërtetimi i kopjeve të dokumenteve origjinale është rregulluar përmes nenit 47 të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë ku ndër të tjera në paragrafin 1 përcaktohet se "*Noteri vërteton vetëm kopjet e dokumenteve origjinale të përgatitura në zyrën e noterit. Noteri mund të vërtetojë gjithashtu kopjet e dokumenteve origjinale të sjellura nga palët për vërtetim, me kusht që kopja e dokumentit të jetë bërë në zyrën e noterit*". Rrjedhimisht kjo pjesë e pretendimit të parashtruesit sa është jo-relevante aq është edhe e paqëndrueshme për shkak të nenit 47 të ligjit për noterinë duke përfshirë edhe dispozitën e sipërcituar. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i parë i parashtruesit është **tërësisht i pabazuar**.

Pretendimet pjesërisht të bazuara

Lidhur me pretendimin e dytë: nga CV e punonjësit Astrit Salihu i tenderuesit të rekomanduar rezulton se ky punonjës ka diplomuar në shkurt të vitit 2017 ndërsa punon që nga tetori i vitit 2017. Kjo nënkupton se i njëjti parimisht ka dukshëm më shumë se dy vite përvojë të punës pas diplomimit sikurse janë kërkuar me DT. Ndërsa sa i përket pjesës së referencave dhe ndërlidhjes së tyre me CV por edhe sa i përket pjesës së thënieve tjera në CV, kjo ka mundur të sqarohet nga tenderuesi i rekomanduar sipas kërkesës së komisionit vlerësues duke u bazuar në nenin 10 të Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurimin Publik. Prandaj pretendimi i dytë është vetëm pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e tretë: sa i përket përputhshmërisë së referencave për punonjës të Arban Grajqevci dhe ndërlidhjes së tyre me CV por edhe sa i përket pjesës së thënieve tjera në CV, kjo ka mundur të sqarohet nga tenderuesi i rekomanduar sipas kërkesës së komisionit vlerësues duke u bazuar në nenin 10 të Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurimin Publik. Për këtë arsye pretendimi i tretë është vetëm pjesërisht i bazuar.

Në këtë mënyrë është gjetur se lidhur me pretendimin e dytë dhe pretendimin e tretë, parashtruesi ka paraqitur argumente pjesërisht të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Rrjedhimisht nga provat materiale të administruara lidhur me këtë kërkesë për rishqyrtim është gjetur se pretendimi i dytë dhe pretendimi i tretë i parashtruesit janë pretendime vetëm pjesërisht të bazuara. Kjo pasi që sipas pretendimit të dytë dhe të tretë është gjetur se komisioni vlerësues nuk ka marrë në konsideratë nenin 10 të Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurimin Publik. Për këto arsye është miratuar si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 13.04.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.